



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Solar Century Holdings Limited nga shoqëria Statkraft European Wind And Solar Holding AS.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa Nr. 341 Prot., protokoll i AK-së, datë 22.09.2020, “Kërkesë për opinion zyrtar: Blerja e Solar Century nga Statkraft AS”, me të cilën jemi njoftuar mbi transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë Solar Century Holdings Limited nga shoqëria Statkraft European Wind And Solar Holding AS.

Sipas Marrëveshjes në lidhje me shitjen dhe blerjen e Solar Century Holdings Limited (SPA kryesore) dhe Marrëveshjet në lidhje me shitjen dhe blerjen e Solar Century Holdings Limited (SPA-të e pakicës) firmosur më datë 1 Nëntor 2020, palët janë:

Pala Blerëse: Statkraft European Wind and Solar Holding AS, është një shoqëri aksionare e themeluar më datë 21.12.2018, sipas legjislacionit të shtetit të Norvegjisë. Ajo vepron si shoqëri holding në Europë për biznesin e Statkraft në sektorin e prodhimit të energjisë nga era dhe dielli. Shoqëria Statkraft European Wind and Solar Holding AS zotërohet tërësisht nga shoqëria Statkraft AS.

Statkraft AS është një shoqëri aksionare, e themeluar më datë 25.06.2004 sipas legjislacionit të Norvegjisë, aktive në gjenerimin dhe tregtimin e energjisë së rinovueshme.

Në Shqipëri Statkraft AS zotëron në mënyrë indirekte, 100% shoqërinë koncesionare Devolli Hydropower e themeluar më datë 17.12.2008, regjistruar datë 18.12.2008.

Target: Solar Century Holdings Limited është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë, më datë 21.12.2018. Shoqëria Solar Century Holdings Limited është zhvillues i projekteve të energjisë diellore në Evropë dhe Amerikën e Jugut (dhe më parë dhe në Afrikë) duke zhvilluar, ndërtuar dhe operuar sisteme fotovoltaike për bizneset dhe fermat diellore. Targeti nuk ka xhiro dhe nuk ka gjeneruar asnjë të ardhur në Shqipëri.

Pala Shitëse:

Shitësit institucional dhe disa shitës individë janë aksionar të shoqërisë target Solar Century Holdings Limited, ku secili shitës zotëron një numër të caktuar aksionesh. Këta shitës janë 17 nga

të cilët 8 janë shoqëri dhe 9 janë individë. Bashkërisht ata do të shesin 81.59% të kapitalit të shoqërisë target ose 82.46% të kontrollit të shoqërisë (në varësi të votës që zotëron aksioni përkatës).

Shitësit individë janë aksionar të shoqërisë target Solar Century Holdings Limited ku secili shitës zotëron një numër të caktuar aksionesh. Shitësit Individual janë 26 individë. Bashkërisht ata do të shesin 6.1% të kapitalit të shoqërisë target ose 4.63% të kontrollit të shoqërisë (në varësi të votës që zotëron aksioni përkatës).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.